# EMRAT/ Operacioni "Mali i kuq", sekuestrohet arsenal armësh dhe drogë, arrestohet një i ri dhe shpallen në kërkim tre të tjerë në Krujë

22 Gusht, 2023 09:59



Madhësia e tekstit:

Një i ri është arrestuar dhe tre të tjerë janë shpallur në kërkim në Krujë.

Uniformat blu bëjnë me dije se në pranga ka rënë shtetasi Mehmet Sallaku, ndërsa janë shpallur në kërkim: Saba Sallaku, Andon Sallaku dhe Ali Sallaku, të tre banues në fshatin Shkretë të Krujës.

Sakaq janë sekuestruar 1 armë zjarri kallashnikov, 21 granata luftarake sulmuese, 17 granata luftarake mbrojtëse, 40 ndezëса unifikues granatash dhe 5.2 kg lëndë e dyshuar narkotike kanabis.

**Njoftimi i policisë:**

Krujë

Finalizohet nga Komisariati i Policisë Krujë dhe Forca e Posaçme Operacionale e DVP Tiranë, operacioni policor i koduar "Mali i kuq".

Sekuestrohen 1 armë zjarri kallashnikov, 21 granata luftarake sulmuese, 17 granata luftarake mbrojtëse, 40 ndezësa unifikues granatash dhe 5.2 kg lëndë e dyshuar narkotike kanabis.

Vihet në pranga 1 shtetas, shpallen në kërkim 3 të tjerë.

Gjithashtu, asgjësohen bimë narkotike që u gjetën të gjetura të kultivuara në afersi të banesës së shtetasit të arrestuar, në fshatin Shkretë.

Nga veprimet hetimore dyshohet se këta katër shtetas janë autorë edhe të kultivimit të 320 bimëve narkotike të gjetura më parë.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Krujë, në vijim të punës për garantimin e rendit dhe sigurisë, evidentimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale, kapjen në flagrancë të shtetasve që kryejnë vepra penale, kontrolleve të ushtruara për parandalimin e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike dhe të rasteve të armëmbajtjes pa leje, kanë intensifikuar kontrollet në të gjithë territorin dhe në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale, kanë finalizuar operacionin policor të koduar "Mali i kuq".

Si rezultat i këtij operacioni u bë arrestimi i shtetasit M. S., banues në fshatin Shkretë. Gjithashtu u shpallën në kërkim shtetasit S. S., 22 vjeç, A. S., 20 vjeç dhe A. S., 41 vjeç, të tre banues në fshatin Shkretë.

Këta shtetas kanë kultivuar bimë narkotike në fshatin Shkretë, në afersi të banesës së shtetasit M. S. Gjatë kontrollit në këtë banesë, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri kallashnikov, 21 granata luftarake sulmuese, 17 granata luftarake mbrojtëse, 40 ndezësa unifikues granatash dhe 5.2 kg lëndë të dyshuar narkotike kanabis.

Nga veprimet hetimore dyshohet se këta shtetas janë autorë edhe të kultivimit të 320 bimëve narkotike, të gjetura dhe të asgjësuara më parë nga Policia.

Vijon puna për kapjen e 3 shtetasve të shpallur në kërkim.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Për t'u bërë pjesë e grupit '**Balkanweb**' mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

**Etiketa:** krujë

BW | GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

Pep Guardiola kryen ndërhyrje kirurgjikale, Manchester City humb trajnerin për dy ndeshje
22 Gusht, 2023


Balla përkujton 30-vjetorin e rënies në detyrë të efektivit të RENEAS, Arben Ujka: ZERO tolerancë për këdo që nuk i ënduet urdhrit ligjshëm të policit
Klodiana Lala | 22 Gusht, 2023

Shkoi të rrëmbente vajzën që donte, pasi familja nuk pranoi zbrazi kallashnikovin drejt banesës, zbardhen detaje nga ngjarja në Skrapar
Enrida Petova | 22 Gusht, 2023

Koncesioni i sterilizimit/ "Asgjë nuk është bërë pa bekimin e Ramës dhe Beqiut", Vokshi: Ish-ministri kërkon të kapet pas fjjes së kashtës, por...
22 Gusht, 2023

Tragjike në Greqi, gjenden të djegur 18 trupa në një pyll në pjesën veriore të vendit
22 Gusht, 2023

Mbappe në "ankand" deri në orët e fundit të merkatos, Real Madrid me plan djallëzor, por rrezikon...
22 Gusht, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

## TË NGJASHME

Grabitësi dhe kërcënuan me armë biznesmenin në Krujë, reagon Balla: Do bëjmë gjithçka që të mos ketë feude apo bajraqe
22 Gusht, 2023

EMRAT/ Arrestohen 4 persona në Krujë, si e vodhën biznesmenin dhe e kërcënuan me armë të tërhiqta kallëzimin. Policia zbulon se...
22 Gusht, 2023

## TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Shkoi të rrëmbente vajzën që donte, pasi familja nuk pranoi zbrazi kallashnikovin drejt banesës, zbardhen detaje nga ngjarja në Skrapar
Enrida Petova | 22 Gusht, 2023

Mashtroi 200 koreanë dhe përfitoi 28 mln euro, 61-vjeçari gjerman kërkon lirinë kundrejt garancisë pasurore, ja çfarë vendosi gjykata
22 Gusht, 2023

"Çmendet" 34-vjeçari, qëllon me kallashnikov një banesë dhe i rrezikon jetën një familjeje, arrestohet
22 Gusht, 2023

EMRAT/ Goditi me sende të forta një burrë dhe një grua në Delvinë, shpallet në kërkim 32-vjeçari
22 Gusht, 2023

"Veprim i çmendur", BMW me shpejtësi skëterrë hipi mbi digë, ekspertët rrugor: Mund të ketë qenë nën efektin e narkotikëve ose...
22 Gusht, 2023

Aksidenti te diga e liqenit në Tiranë/ "Me shpejtësi mbi 250 km/h", gazetari Shoferi u pa të largohej i lënduar nga vendngjarja
22 Gusht, 2023

## KATEGORIA VIDEO

Koncesioni i sterilizimit/ "Asgjë nuk është bërë pa bekimin e Ramës dhe Beqiut", Vokshi: Ish-ministri kërkon të kapet pas fjjes së kashtës, por...
22 Gusht, 2023

Mashtroi 200 koreanë dhe përfitoi 28 mln euro, 61-vjeçari gjerman kërkon lirinë kundrejt garancisë pasurore, ja çfarë vendosi gjykata
22 Gusht, 2023

"Veprim i çmendur", BMW me shpejtësi skëterrë hipi mbi digë, ekspertët rrugor: Mund të ketë qenë nën efektin e narkotikëve ose...
22 Gusht, 2023

Aksidenti te diga e liqenit në Tiranë/ "Me shpejtësi mbi 250 km/h", gazetari Shoferi u pa të largohej i lënduar nga vendngjarja
22 Gusht, 2023

Gjeste të pahijshme në tribunë, thëllëhet skandali rreth Rubiales, vjen dha denoncimi i parë
22 Gusht, 2023

Nga "Kruga e Kosovarëve" fluturon mbi digë, Velioj publikon videon e aksidentit: Dëmimin maksimal për shoferin!
22 Gusht, 2023



© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.